2. Kur autoritetet /entet kontraktore vërejnë se oferta është anomalisht e ulët, i kërkojnë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni.- Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më shumë se 25% të fondit limit të përllogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin / elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

3 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

4 Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrjigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

5. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

G. DHËNIA E KONTRATËS

27. Njoftimi i Fituesit Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

28. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës 1 Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2 Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

I. ANKESAT

29. Procedura e ankesës .1 Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin dhe /ose përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë për t'u ftuar për të paraqitur oferta, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.

2 Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

30 Anulimi i procedurës 1 Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2 Autoriteti kontraktor publikon vendimin e anulimit vetëm pas kalimit të afateve të ankimimit sipas parashikimeve të nenit 110 të LPP.

3. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

- a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;

- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

4. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të pikes 3, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Kërkesës për pjesëmarrje

Shtojca 2. Ftesa për Ofertë për kandidatët e përzgjedhur faza II

Shtojca 3. Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 4 Lista e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 5. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 6. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 7. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 8. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 9. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 10. Formulari i Kriterëve Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 11. Formulari i Përmbledhës i Vetdeklarimit

Shtojca 12. Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 13. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Shtojca 14. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 15. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

Shtojca 16. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 1

(Shtojca për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik)

FORMULARI I KËRKESËS PËR PJESËMARRJE

Emri i **Operatorit Ekonomik** _____

Drejtuar: *[Emri dhe adresa e autoritetit /entit kontraktor]*

* * *

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Numri i procedurës / referenca e Lotit

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Botimi (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data]

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, në, të nënshkruarit paraqesim shprehjen tonë të interesit për të marrë pjesë në këtë procedurë.

Emri i Përfaqësuesit të Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 2

*(Shtojcë për tu plotësuar nga autoriteti /enti kontraktor vetëm për operatorët ekonomikë të kualifikuar/
përzgjedhur bazuar në kërkesen per pjesëmarrje)*

FORMULAR I FTESËS PËR OFERTË

[Datë]

Drejtuar: *[Emri dhe adresa e operatorit ekonomik të kualifikuar /përzgjedhur]*

Procedura e prokurimit _____/

Numri i procedurës / referenca e Lotit _____

Në referencë të procedurës së lartpërmendur ju bëjmë me dije se [emri dhe adresa e kandidatit të përzgjedhur], pas vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur në fazën e parë Ju jeni kualifikuar për fazën ofertuese të kësaj procedure prokurimi.

Për këtë arsye, ju kërkohet të paraqisni pranë [këtij autoriteti/enti kontraktor]

Emri _____

Adresa _____

Ofertën tuaj, duke marrë në konsideratë si më poshtë:

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertës është:

Data (d/m/v)

Ora: _____

Adresa _____

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin ofertën në formë elektronike në ueb-faqen zyrtare të APP, www.app.gov.al.

Informacioni mbi ofertat e paraqitura me mjete elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.

Gjuha (ët) e hartimit të ofertës është:

Shqip Anglisht

Tjetër _____

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit janë si më poshtë:

A) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

Sipas rëndësisë:

Çmimi pikët

_____ pikët

_____ pikët

_____ pikët

Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë pikët për cdo kriter vlerësimi të përcaktuar.

OSE

B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Në rastin e Marrëveshjes Kuadër, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave do të kryhet në bazën e shumës së çmimeve për njësi (Kjo metodë e vlerësimit nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore në rastet kur sasi të janë të vlerësueshme në bazë vjetore sipas përvojës së mëparshme dhe kur Marrëveshja Kuadër është përdorur për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në rast të tillë çmimi më i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët ofruar).

Mbetemi në pritje të marrjes së ofertës suaj.

[Drejtuesi i autoritetit /entit kontraktor]

Shtojca 3.**LOTI 1 ME OBJEKT “SHËRBIM LAVANDERIE PËR SPITALIN RAJONAL LEZHË”**

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik i ftuar për të paraqitur ofertën)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne ofrojmë t’i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e kontratës;
3. Kriteret e përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafiku i ekzekutimit;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.**LOTI 2 ME OBJEKT “SHËRBIM LAVANDERIE PËR SPITALIN RAJONAL BERAT”**

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik i ftuar për të paraqitur ofertën)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne ofrojmë t’i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e kontratës;
3. Kriteret e përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafiku i ekzekutimit;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.**LOTI 1 ME OBJEKT “SHËRBIM LAVANDERIE PËR SPITALIN RAJONAL LEZHË”***(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë shërbimet në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbime Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të pa ofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Shërbim i	Përshkrimi i shërbimit	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim(3 x 4X)	
1.	Shërbim lavanderie për Spitalin Rajonal Lezhë	134,006.458 kg			
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Shërbimet)				_____

Çmimi Neto pa TVSH	
TVSH (%)	
Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.**LOTI 2 ME OBJEKT “SHËRBIM LAVANDERIE PËR SPITALIN RAJONAL BERAT”***(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë shërbimet në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbime Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të pa ofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Shërbimi	Përshkrimi i shërbimit	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim(3 x 4X)	
1.	Shërbim lavanderie për Spitalin Rajonal Berat	76,368 kg			
2.					
3.					

4					
	Çmimi total (Shërbimet)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 5.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]
 [*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

* * *

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*] / Nr. Referencës në faqen e APP-
se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit/entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentet e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 6

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 7.**LOTI 1 ME OBJEKT “SHËRBIM LAVANDERIE PËR SPITALIN RAJONAL LEZHË”**

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

- Sipërmarrësi do të tërheqë çdo ditë rrobat për larje pranë dhomave të pranimit se Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Lezhë nga ora 7.³⁰ deri në orën 9.⁰⁰ kundrejt dokumentacionit përkatës.
- Sipërmarrësi do të kthejë rrobat e lara, të hekurosura dhe të vendosura në qese amballazhi të specifikuar çdo pavion çdo ditë nga ora 8.³⁰ deri në orën 10.³⁰.
- Rrobat që do të tërhiqen nga dhomat e infektivit duhet të kenë amballazh të veçantë me ngjyrë të veçantë. Larja e tyre duhet të bëhet me lavatriçe të veçanta.
- Solucionet larëse të rrobave duhet të plotësojnë të gjitha parametrat përkatëse dhe sipas nevojës të përdoren dizifektantë të ndryshëm.
- Në rast dëmtimesh të rrobave gjatë procesit të larjes sipërmarrësi duhet të bëjë riparimet e tyre.
- Marrja e rrobave do të bëhet përditë me një dokument provizor në bazë të peshës dhe sasisë së tyre pranë ambjentit të caktuar për këtë qëllim nga Autoriteti Kontraktor, duke bërë numërimin e tyre dhe peshimin e tyre.
- Dorëzimi i rrobave të lara do të bëhet përditë me një dokument provizor në bazë të peshës dhe sasisë së tyre pranë ambjentit të caktuar për këtë qëllim nga Autoriteti Kontraktor, duke bërë numërimin dhe peshimin e tyre.
- Në procesin (çmimin) e larjes do të përfshihen edhe riparimet e ndryshme që mund të ndodhin gjatë pastrimit, si dhe larja e batenijave dhe jastekëve etj.
- Operatori ekonomik duhet të marrë përsipër furnizimin e Spitalit me ndërresa sipas kërkesës edhe në rastet kur lavatricet apo tharëset janë me defekt apo të ndonjë avarie elektrike apo të ndonjë ngjarje të paparashikuar.

DIZENFEKTIMIN DHE LARJEN E RROBAVE NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

Në përhapjen e infeksioneve brenda në spitale si rrugë transportimi të rëndësishme shërbejnë dhe rrobat e trupit dhe të shtratit që përdoren për të sëmuret. Këto rroba ndotin mjedisin rrethues me mënyra të ndryshme duke shpërndarë kudo mikrobe, nëpërmjet korentëve të ajrit që formohen gjatë manipulimeve të ndryshme dhe si rrjedhim krijohen mundësitë për ndotjen e dhomave, salloneve, pavioneve që cojnë në shfaqjen e infeksioneve brenda spitalit.

Mënyra e grumbullimit, qarkullimit, dezinfektimit dhe larjes së tyre ka rëndësi të madhe epidemiologjike dhe higjeno-sanitare dhe njohja e zbatimit me rreptësi i këtyre rregullave nga personeli mjekësor do të bëjë që të evitohet sa të jetë e mundur shfaqja e këtyre infeksioneve.

Pranimi i rrobave

Për pranimin e rrobave të ardhura nga pavionet në lavanteri ka një mjedis të vecantë dhe të bollshëm ku bëhet numërimi dhe ndarja e tyre.

Ndarja e materialeve të buta bëhet sipas shkallës së ndotjes dhe sipas asortimenteve në mënyrë që Materialet e buta, si carcafe, këllef jasteku të lahen vec nga matreialet e buta si: peshqirë ose këmisha.

Materialet e buta ndahen dhe sipas ngjyrës.

Larja e rrobave që vijnë nga pavionet bëhet brenda ditës.

Dezinfektimi i rrobave

Në fillim bëhet ndarja e teshave sipas shkallës së ndotjes së tyre dhe dezinfektimi i tyre bëhet me anë të solucioneve përkatëse.

Pas mbarimit të kohës së ekspozimit teshat nxirren dhe dërgohen për t'u larë.

Dysheket, jasteket, batanijat.

Batanijat konsiderohen si grumbulluesit më të rëndësishëm të pluhurave. Për të evituar ndotjen e tyre Dyshekët dhe jastekët duhet të mbështillen me këllef dysheku.

Batanijat duke qenë se janë të ekspozuara direkt ndaj pluhurave grumbullojnë mikrobe. Mënyra më e mirë dhe më e sigurtë e tyre është dezinfektimi i tyre me autoklav të mëdhenj ose spërkatja e tyre me solucion dezinfektues. Në spitale ose reparte, dezinfektimi i tyre bëhet pas daljes së cdo të sëmurit nga spitali.

Larja e rrobave

Ky proces është i rëndësishëm dhe për këtë qëllim duhen zbatuar me përpikmëri koha e dhënë në procesin teknologjik.

Proceset e punës në repartin e larjes duhet të kryhen në mënyrë të tillë që të mënjanohet kryqëzimi i rrobave të ndotura me rrobat e lara. Për këtë arsye në repartin e larjes duhet që patjetër të kufizohet pjesa “jo e pastër” nga pjesa e “pastër”. Ky kufizim i bëhet të ditur personelit duke caktuar rrugët dhe mjetet e transportit .

Spitali Rajonal Lezhë disponon materialet e buta si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i produktit	Njësia	Sasia qe disponon spitali	Specifikimet Teknike	Dimensio net	Frekuenca e larjeve të rrobave në vit	Lloji I materialit
1	Çarçafë tek të sipërm	Copë	737	160 – 180 gr/m2, Me qepje nga të katërta anët. Ngjyrë e bardhë. Logo SRL	160x220 cm	88	75% pambuk x 25% polyester, Lahet në temperature 60 grade

2	Pizhame	Palë	325	Pambuk I plote xhaketa me krahe te gjate, me jake ose forme V. Pantallonat me llastik ne bel, njengjyreshe. Pesha 0.6-0.65 kg	Xhaketa 71 cm. Pantallona 120, +-5cm	64	përbërje 100% pambuku, me larje në temp 90 °.
3	Këllefë jasteku	Copë	267	Nga njëra anë ka një të çarë si xhep, për të lejuar futjen e jastëkut. Ngjyrë e bardhë. 160 – 180 gr/m2. Logo SRF.	60x80 cm	83	100% pambuk
4	Këllef dyshekësh (mushama)	Copë	122	Material nga njëra anë pambuk dhe nga ana tjetër e gomuar impermeable (e papershkueshem nga uji), qepje me llastik për të futur dyshekun	200 cm x 90 cm x 20 cm	12	nga njëra anë pambuk dhe nga ana tjetër e gomuar impermeable (e papershkueshem nga uji) larje në temp 60 °.
5	Pandofla pacienti Adult	Palë	118	Lëkurë ngjyrë e bardhë, me vrima për ajrosje me shtresë ortopedike për qëndrimin për kohë të gjatë në këmbë. Pesha 0.3-0.4 kg	Numrat nga: 38–43	2	
6	Jastekë	Copë	267	Mbushje uniforme me fibra sintetike. Ngjyre e bardhe, me mbulese dyshe	50x80 cm Pesha 800gr	4	Larje në te thate
7	Peshqirë duarsh	Copë	150	Material pambuk, me ngjyra të ndryshme, me permasa 90x 50 cm me thurje me vjega. 350- 400g/m2.	90 x 50	91	pambuk 100% lahet në temp 90°
8	Boçe	Copë	65	material pambuk . Masa 150-160 g/m2	75 x 90	91	pambuk 100% lahet në temp 90°
9	Carcafe salle	Copë	45	Material pambuk, ngjyre jeshile, masa 180-200g/m2	300 x220 cm	49	pambuk 100% lahet në temp 90°
10	Batanije	Copë	175	60% lesh dhe 40 % akrilik	Permasat 220*160cm, Masa 600-800 gr/m2.	24	Larje ne 40 grade.

Shtojca 7.**LOTI 2 ME OBJEKT “SHËRBIM LAVANDERIE PËR SPITALIN RAJONAL BERAT”**

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Parametrat teknikë që duhet të plotësohen gjatë zbatimit të kontratës/ave që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër:

1. Të realizohet shërbimi i larjes së të Butave Spitalore (çarçafë, batanije, mushame e gomuar, përparëse mjeku, kostum infermieri, peceta kirurgjie/obstetrike, peshqira, këllëf jastëku, etj.)
2. Teshat të pastrohen mirë me detergjent të çertifikuar dhe zbutës teshash.
3. Teshat pas larjes duhet të thahen, të hekurosen dhe të paketohen.
4. Teshat të merren, të dorëzohen duke mbajtur dokumentacionin përkatës dhe transporti i tyre të jetë me paketim, që i mbron nga ndotja.

Shtojca 8**LOTI 1 ME OBJEKT “SHËRBIM LAVANDERIE PËR SPITALIN RAJONAL LEZHË”***(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)**(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)***FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT****Shërbimi që kërkohet:****Shërbim lavanderie për Spitalin Rajonal Lezhë****Afatet e ekzekutimit:**

Shërbimi	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
Shërbim lavanderie për Spitalin Rajonal Lezhë	Sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës	134,006.458 kg	Spitali Rajonal Lezhë	Sipas nevojave të AK, brenda periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër

Shtojca 8**LOTI 2 ME OBJEKT “SHËRBIM LAVANDERIE PËR SPITALIN RAJONAL BERAT”***(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)**(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)***FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT****Shërbimi që kërkohet:****Shërbim lavanderie për Spitalin Rajonal Berat****Afatet e ekzekutimit:**

Shërbimi	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
Shërbim lavanderie për Spitalin Rajonal Berat	Sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës	76,368 kg	Spitali Rajonal Berat	Sipas nevojave të AK, brenda periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër

Shtojca 9**LOTI 1 ME OBJEKT “SHËRBIM LAVANDERIE PËR SPITALIN RAJONAL LEZHË”****FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **“Shërbimi i Lavanterisë për Spitalin Rajonal Lezhë”**.

Detyrat: Operatori i kontraktuar duhet të ofrojë shërbimin e grumbullimit të të gjithë materialit të butë të papastër në bazë të rregullores së parandalimit të infeksioneve nozokomiale, transportimin e tij në lavanderi, seleksionimin, larjen, hekurosjen, paketimin, transportimin sërisht mbrapsht në Spital dhe Maternitet (ku materiali i larë nuk duhet të ketë kontakt me materialin e palarë për të shmangur infeksionet). Punësimin e mjaftueshem të personelit për ofrimin e shërbimit:

Monitorim të vazhdueshem të kushteve të kontrates;

Duke pasur parasysh natyrën spitalore, është e domosdoshme dhe e rëndësishme, që materiali i butë për t'u larë duhet të tërhiqet sa më shpejt nga dhomat e pranimit, bazuar në manualin e kujdeseve spitalore dhe rregullave të higjienës (selektimi sipas ndotjes së materialit të butë në thasët me ngjyrë). Moslargimi në kohë i këtyre materialeve të buta, do të çojë në rritjen e infeksioneve spitalore me efekt final uljen e performancës së ofrimit të shërbimit ndaj pacientëve, rritjen e ditëqendrimit, rritjen e përdorimit të medikamenteve (kryesisht antibiotikëve).

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Në ambientet e Spitalit Rajonal Lezhë

Shtojca 9**LOTI 2 ME OBJEKT “SHËRBIM LAVANDERIE PËR SPITALIN RAJONAL BERAT”****FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Qëllimi i kësaj kontrate është realizimi i shërbimit të larjes së të “Butave Spitalore”, sipas specifikimeve teknike, për Spitalin Rajonal Berat, si dhe të realizohet një shërbim cilësor e korrekt deri në përfundim të marrëveshjes kuadër.

Detyrat:

Parametrat teknikë që duhet të plotësohen gjatë zbatimit të kontratës/ave që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër:

1. Të realizohet shërbimi i larjes së të Butave Spitalore (çarçafë, batanije, mushame e gomuar, përparëse mjeku, kostum infermieri, peceta kirurgjie/obstetrike, peshqira, këllëf jastëku, etj.)
2. Teshat të pastrohen mirë me detergjent të çertifikuar dhe zbutës teshash.
3. Teshat pas larjes duhet të thahen, të hekurosen dhe të paketohen.
4. Teshat të merren, të dorëzohen duke mbajtur dokumentacionin përkatës dhe transporti i tyre të jetë me paketim, që i mbron nga ndotja.

Shpërndarja: Sipas kërkesave të Spitali Rajonal Berat

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Spitali Rajonal Berat

Shtojca 10

LOTI 1 ME OBJEKT “SHËRBIM LAVANDERIE PËR SPITALIN RAJONAL LEZHË”

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 11.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 11*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5 ;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 10 të DST.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021-2022-2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përllogaritur e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2021, 2022, 2023), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limitit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi, qira ose në përdorim **të paktën 1 (një) ambient, ku shtron veprimtarinë për kryerjen e shërbimit lavanderisë objektit prokurimit.**

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- akt miratimi higjieno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Të dhënat e ambientit të kërkuar që do të deklarohet, detyrimisht do t'i paraqiten Autoritetit Kontraktor, për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë certifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë si më poshtë:

- **SSH EN 14065:2016** mbi “Sistemin e kontrollit të Biokontaminimit”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë leje mjedisore të Tipit B “Pastrim kimik” (të vlefshme), lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet, në fushën e objektit të prokurimit.

2.3.5 Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 7 (shtatë) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

NR.	Stafi	Nr.
a)	Drejtues Teknik	1 (një)
b)	Punëtore në Lavanderi	3 (tre)
c)	Punonjës shërbimi në Reparte të AK	3(tre)
	Totali i punonjësve	7 (shtatë)

- a) Drejtuesi Teknik duhet të ketë eksperiencë pune të ngjashme të paktën 2 (dy) vite.
Për Drejtuesin Teknik, OE duhet të paraqesë:
- Kontratë individuale pune (e vlefshme), si drejtues teknik;
 - Diplomë e arsimit të lartë;
 - Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën e kërkuar.
- b) Për punonjësit Punëtor në Lavanderi, dhe punonjësit e shërbimit në Reparte të AK të paraqitet vetëm kontratë individuale pune (e vlefshme) përkatëse.

Të dhënat për punonjësit e kërkuar që do të deklarohen, detyrimisht do t’i paraqiten Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 11 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.6 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të deklarojnë se punonjësit e deklaruar për këtë procedurë prokurimi: Drejtuesi Teknik dhe Punonjës shërbimi në Reparte të AK nuk do të jenë të angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon, makineritë, dhe pajisjet, si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
1	Makine larëse Profesionale (me kapacitet mbi 60 kg secila)	Cope	2 (dy) ose me kombinim pajisjesh,	Në pronësi ose me qira, ose përdorim

			për plotësimin e sasisë se përcaktuar nga AK.	
2	Makinë Pastrimi Kimik Profesionale, (me kapacitet mbi 20 kg)	Copë	1 (një) ose me kombinim pajisjesh, për plotësimin e sasisë se përcaktuar nga AK.	Në pronësi ose me qira, , ose përdorim
3	Makinë tharese profesionale (me kapacitet mbi 20 kg secila)	copë	2 (dy) ose me kombinim pajisjesh, për plotësimin e sasisë së përcaktuar nga AK	Në pronësi ose me qira, ose përdorim
4	Makinë Hekurose (Rul) Profesionale	Copë	1 (një)	Në pronësi ose me qira, ose përdorim
5	Peshore elektronike mbi 100 kg, e cila duhet të jetë kalibruar dhe të shoqërohet me akt kolaudimi të lëshuar nga autoritetet përkatëse (Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise)	Copë	1 (një) ose me kombinim pajisjesh, për plotësimin e sasisë se përcaktuar nga AK.	Në pronësi ose me qira, ose përdorim

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qira, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Të dhënat për pajisjet e kërkuara që do të deklarohen detyrimisht do t'i paraqiten Autoritetit Kontraktor, për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 11 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transport, me qëllim transportin e materialit të butë, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, sipas tabelës së mëposhtme:

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

- dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qira, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me

anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

- lejen e qarkullimit të mjetit

Të dhënat që do të deklarohen, detyrimisht do t'i paraqiten Autoritetit Kontraktor, për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 11 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.9 Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

2.3.10 Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër shërbimin e larjes me produkte, cilësia CE/ dhe ose/të pajisur me certifikatë konformiteti.

Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpika 1 e seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në një Lot.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10

LOTI 2 ME OBJEKT “SHËRBIM LAVANDERIE PËR SPITALIN RAJONAL BERAT”

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 11.

